

# VLERESIM I POTENCIALEVE KONKURRUESE TË INDUSTRIVE SHQIPTARE TË TEKSTILE/VEHJEVE E LËKURË/KËPUCËVE NË NJË KËNDVËSHTRIM NDËRKOMBËTAR

## **1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM**

Tekstile/veshjet dhe lëkurë/këpucët kanë qenë dy nga industrite kryesore të ekonomisë shqiptare në periudhën e viteve 1960-1990. Ndermarrjet e këtyre industrive ishin shtetërore dhe industrite operonin brenda natyrës së një ekonomie socialiste. Prodhimi i atehershem përfshinte një gamë të gjërë të produkteve të zinxhirit të vlerës së shtuar duke filluar që nga fibrat e lëkurës dhe deri tek produktet e gatshme. Kërkesa konsumatore plotësohej nga prodhimet vendase. Eksporti i mallrave ishte nën përgjegjësinë e një agjencie shtetërore të vetme.

Pas viteve '90, ndermarrjet e këtyre industrive u privatizuan. Një pjesë e mirë nuk e ndryshuan destinacionin. Aktivitetet prodhuese u fokusuan në prodhimin me fason të veshjeve dhe faqeve të kepuceve, të cilat përbejnë njëkohësisht edhe pjesën dermuese të eksporteve të vendit. Nevojat konsumatore për tekstile e veshje plotësohen nga produktet e importit. Industria e lëkurës, e mbështetur edhe nga rritja e numrit të krereve, ka pësuar një rritje të eksporteve të produkteve gjysem të gatshme. Markat kombëtare mungojnë dhe lidhjet me furnizuesit dhe me kanalet e shitjes janë tepër të dobëta, përveç produkteve të ri-eksportit, tregjet e të cilave sigurohen nga investitorët dhe porositësit e huaj.

Keto industri luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Siç paraqitet edhe në Tabelën 1, prodhimi i industrisë së tekstile/veshjeve në vite është rritur, si rezultat i gjetjes së tregut shqiptar të punës me leverdi ekonomike për prodhime që përdorin intensivisht punën e që eksportohen në tregjet e BE-së. Në vitin 2001 ka një rënie të numrit të të punësuarve si rezultat i zvogelimit të numrit të firmave, për shkak të krizës energjitike. Ky fakt ka çuar edhe në investime më të ulëta në këto industri. Por rritja e prodhimit e shoqëruar me zvogelimin e të punësuarve tregon për rritjen e produktivitetit të punës në firmat egzistuese. Rritja e produktivitetit i atribuohet kryesisht manaxhimit dhe organizimit në nivel firmë. Përsa i përket numrit të firmave, industria e tekstileve renditet pas industrive ushqimore, dru-mobiljeve dhe asaj metalurgjike e përpunimit të metaleve. Nderkohe përsa i përket numrit të të punësuarve kjo industri kryeson listën e të gjitha industrive të lehta duke u quajtur me të drejtë një industri përdoruese intensive e punës. Renditja në nivelin e investimeve ka ndryshuar në vite. Kështu në 1999 ajo renditej e dyta në listën e industrive përpunuese (pas industrisë së lëkurë-kepuceve), nderkohe që në 2001 ndodhet pas shumë degeve të tjera, kjo edhe si rezultat i alokimit të madh të burimeve të ekonomisë në 2001 në industrinë ushqimore e të pijeve dhe në atë të përpunimit të metaleve, të cilat kanë përjetuar një bum investimesh duke zënë të dyja së bashku 60% të totalit të investimeve në industrinë përpunuese.

**Tabela 1:** Te dhena te pergjithshme

<b>Industria e tekstile/veshjeve</b>									
Te dhena te pergjithshme	1999 (ne milion leke)	Kontributi gjate vitit 1999		2000 (ne milion leke)	Kontributi gjate vitit 2000		2001 (ne milion leke)	Kontributi gjate vitit 2001	
		ndaj ekonomise pa bujqesine	ndaj industrise perpunuese		ndaj ekonomise pa bujqesine	ndaj industrise perpunuese		ndaj ekonomise pa bujqesine	ndaj industrise perpunuese
Prodhimi	3,235	2%	8%	4,245	2%	10%	4,935	2%	9%
Numri i te punesuarve	8,626	6%	24%	9,129	6%	25%	8,865	4%	27%
Paga mesatare	10,734	-11.4%		11,708	-12.3%		14,056	-5%	
Numri i firmave	327	0.9%	9%	347	1%	10%	298	0.8%	8%
Niveli i investimeve	690 milion leke	2%	19%	616	2.6%	7.6%	477	0.8%	4%
<b>Industria e lekure/kepuceve</b>									
Prodhimi	3,683	2%	9%	4,498	3%	11%	5,530	3%	10%
Numri i te punesuarve	4,431	3%	13%	4,560	3%	12%	5,158	4%	14%
Paga mesatare	10,734	-11.4%		11,708	-12.3%		14,056	-5%	
Numri i firmave	68	0.2%	2%	62	0.2%	2%	76	0.2%	2%
Niveli i investimeve	1,133	4%	31%	165	0.7%	2%	925	2%	8%

**Burimi:** INSTAT. Rezultate te Anketes Strukturore te Ndermarrjeve Ekonomike 1999, 2000, 2001

Pamja e tregtise se jashtme eshte reflektim direkt i struktures prodhuese te brendshme, e cila i eshte pergjigjur politikës tregtare te BE-se per prodhimin me porosi (OPT = Outward Processing Trade) ne vendet e Evropes Lindore e Qendrore, Azi dhe Mesdhe. Eksportet dhe importet paraqiten te nderlidhur me njeri-tjetrin si pasoje e praktikës se ri-eksporteve. Importet jane kryesisht produkte gjysem te gatshme te cilat rieksporthen pas kryerjes se nje apo dy operacioneve perpunuese te permbarimit.

Nivelet e eksporteve dhe importeve te tekstile/veshjeve kane patur pergjithesisht tendence rritese, ashtu sic paraqitet edhe ne Tabelen 2. Pesha e ri-eksporteve ne vitet e fundit ka variuar nga 73-81% ndaj totalit te eksporteve te kesaj industrie. Bilanci tregtar i kesaj industrie paraqitet pozitiv se fundmi.

**Tabela 2:** Eksportet dhe importet e industrise se tekstile/veshjeve ne vite, ne mije €

Indikatore te tregtise	1999	2000	2001	2002
Eksporti tregtar	150,179.9	176,587.8	214,874.3	224,576.4
Importi tregtar	218,444.5	164,030.6	197,179.8	221,092.1

**Burimi:** ACIT, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, Marreveshja e OBT-se

Peshen kryesore te eksporteve tekstile shqiptare e zene “Suprinat dhe pjeset prej tyre prevec pajandrave prej materialeve te tjera” me 20.3% te totalit te eksporteve tekstile, 2002, “Te tjera pantallona, dhe pantallona me kembe te shkurtra prej pambuku” me 12.4%, “Kemisha burrash dhe djemsh prej pambuku” me 7.5% te ndjekura nga bluzat e kemishat per femra (5.4%) dhe mbathjet e brendshme (5.3%). Sic vihet re, portofoli i produkteve tekstile te eksportuara te Shqiperise eshte pak i diversifikuar. Nente lloje produktesh perfaqesojne rreth 62% te portofolit te eksporteve tekstile. Keto nente produkte, ndonese bejne pjese ne fazat e larta te zinxhirit te produkteve tekstile, nuk sjellin vlere te shtuar te larte per arsye te angazhimit ne nje apo dy operacione mbi gjysem produkte te gatshme te importuara qe perdorin intensivisht punen per faza permbarimi (*assembling*). Struktura prodhuese (teknologjia, forca punetore, proceset, etj) eshte kryesisht e pershtatur per prodhimin e ketyre klasave te produkteve te veshjeve te jashtme e te brendshme. Per me teper, ne rastet kur investimet jane te kompanive te huaja, fitimet nuk mbeten brenda vendit.

Prodhimi i industrise se lekure/kepuceve ka pesuar nje rritje nga viti 1999 ne 2001 (shih Tabelen 1). Kontributi i saj ne industrine perpunuese arrin ne 10% dhe se bashku me kontributin ne punesim (14%) perben nje nga deget me me rendesi ekonomike e sociale. Investimet dhe numri i firmave ne kete industri, ndonese me luhatje, kane tendence rritese ne vlere absolute. Nderkohe, pesha e tyre ne totalin e ekonomise apo te industrise perpunuese ka ndryshuar, vecanterisht persa i perket investimeve, per shkak te rritjes se peshes se investimeve ne industri te tjera si metalurgjike e perpunimit te metaleve si edhe te perpunimit ushqimor. Prodhimi ne kete industri dominohet nga prodhime per ri-eksport te faqeve te kepuceve per tregjet e cilesise se larte ne Evrope. Bilanci tregtar i kesaj industrie paraqitet pozitiv si rezultat i vleres se larte te ri-eksportit. Pesha e ri-eksporteve ne totalin e eksporteve te kesaj industrie eshte mesatarisht 83% ne vitet e fundit.

**Tabela 3:** Eksportet dhe importet e industrise se lekure/kepuceve ne vite, ne mije €

Indikatore te tregtise	1999	2000	2001	2002
Eksporti	68,355	54,968	59,672	82,324
Importi	49,386	40,391	58,791	77,486

**Burimi:** ACIT, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, Marreveshja e OBT-se

Nderkohe peshen e eksporteve kryesore ndaj totalit te industrise se lekure/kepuceve e zene suprinat prej lekure (55%) te njohura ndryshe si faqet e kepuceve. Keto produkte gjysem te gatshme te ri-eksportuara perdorin intensivisht punen e dores. Ato eksportohen thuajse teresisht ne Itali (99%). Lekurat e paperpunuara (klasa 41) jane gjithashtu nje ze me peshe (14.5%) ne totalin e eksporteve te kesaj industrie. Ato jane te destinuara kryesisht per tregun italian, turk e grek. Lekura e perpunuar e gjedheve (vicit kryesisht) eshte me e rendesishmja ne eksportin e lekureve si lende e pare, per shkak te koston se ulet te perpunimit te saj ne Shqiperi, si rezultat i shkeljeve ne legjislacionin mjedisor. Ajo perfaqesohet nga lekure e perpunuar vendi ose perpunim lekure te huaj me fason.

Lista e blesesve te huaj eshte e kufizuar ne pak vende te Bashkimit Evropian (Itali, Greqi, Gjermani) te cilat perbejne destinacionet kryesore. Vende te rajonit si Kroacia, Maqedonia, Jugosllavia ndodhen gjithashtu ne listen e tregjeve te eksportit, ndonese me

shifra teper modeste. Italia eshte vendi ku eksportohen mbi 80% e tre klasave kryesore tekstile. Shkaqet e perqendrimit te eksportit te produkteve te caktuara ne tregje te caktuara shpjegohen se pari me natyren ri-eksportuese te prodhimit te ketyre produkteve te sipermarra nga firma italiane, greke, etj, ku keto te fundit kane te garantuara tregjet e tyre te shitjeve dhe percaktojne vendimet e prodhimit. Gjithashtu, shkalla e ulet e inteligjences se tregut ka kufizuar akoma me shume portofolin duke mos alokuar burime (dizenjo, teknologji, burime financiare, etj) ne prodhime tekstile te tjera per te cilat mund te gjenden tregje (*niche*) te huaja. Prezenca e eksporteve te disa produkteve apo tregjeve te caktuara (shih Aneks 3), edhe pse ne shume raste jane shume te uleta, perben sinjal qe tregon per nje shans qe ndonese eshte shfaqur ne menyre rastesore, ia vlen te studiohet me thelle. Te tilla sinjale mund te merren per eksportin e fibrave natyrore (lesh, mendafsh) ne tregje te tilla si Austri, Gjermani, etj, filamente te bera nga njerezit, qylyma e sixhade, qendistari e pune dore apo trikotazhe per eksport ne vendet anetare te BE-se. Gjithashtu importi i shume produkteve te ketyre industrive (shih Aneks 6 dhe 7) perben nje sinjal per mundesi biznesi per plotesimin e kerkeses vendase per produkte importi me prodhime vendi.

## 2. KUSHTET E FAKTOREVE

### a. Faktori njerezor

**Numri i te punesuarve.** Ky numer per industrine e tekstile/veshjeve arrin ne rreth 9,000 njerez mesatarisht ne vit (shih Tabelen 1). Per vitin 2001, kjo industri puneson 4% te forces aktive (perjashtuar punezenien ne bujqesi) dhe 27% ne industrine perpunuese, duke perbere ne kete menyre nje sektor me rendesi sociale dhe njekoheisht me natyre perdoruese intensive te punes. Ne rang boteror, sektori i tekstile/veshjeve puneson 14% te forces aktive, ndersa ne BE 7.6% te industrise perpunuese (rreth 2 milion njerez). Ne thelb ky mbetet nje sektor mbareboteror me sensitivitet te larte social e ekonomik. Industria e lekure/kepuceve perben gjithashtu nje sektor me rendesi persa i perket punesimit. Mesatarisht 5,000 te punesuar regjistroheshen cdo vit ne kete sektor ne Shqiperi (shih Tabelen 1) me nje peshe prej 14% ndaj industrise perpunuese.

**Kualifikimi i forces punetore.** Per shkak te eksperiences prej disa dekadash ne industrine e tekstile/veshjeve dhe kepuceve, egziston dhe vazhdon te krijohet nje force punetore e kualifikuar per procese te caktuara operationale (te qepjes, prerjes, hekurosjes, etj). Kualifikimi i kesaj shtrese te forces punetore eshte nxitur akoma me shume nga zhvillimi i sektorit privat per prodhimin e konfeksioneve dhe faqeve te kepuceve. Por kjo gje nuk mund te thuhet per profesione te nivelit me te larte te kualifikimit si inxhinier, dizenjatore, manaxhere, kerkues tregu, marketiere, kimiste, etj. Aktualisht numri i institucioneve qe kualifikojne forcen e kualifikuar te punes eshte i vogel (nje Fakultet i Inxhinierise Tekstile, nje Akademi Artesh - dega dizenjator, shkolla/kurse rrobaqepsie, trainime ne ambientin e punes, trainime nga OJQ, Fakulteti Ekonomik - dega manaxhim dhe marketing, te cilat ndodhen kryesisht ne rrethin e Tiranes). Gjithashtu, niveli i ulet i pagave ne keto industri, nuk e ben ate atraktive per forcen e kualifikuar. Dizenjoret e rinj qe kane filluar madje te hapin shtepite e tyre te modes, deshmojne per rendesine dhe

suksesin qe mund te kete dizenjimi i kombinuar me nje marketing te mire. Baza e permiresimit dhe zhvillimit te kesaj industrie ne lidhje me forcen e punes mbeten manaxheret, dizenjatorët, marketierët, inxhinierët dhe kimistet.

E njejta situatë paraqitet pak a shume edhe ne vendet ne zhvillim dhe vecanterisht ne vendet e Evropes Lindore, ku niveli i kualifikimit te forces punetore eshte nje nga faktoret qe shpjegon mungesen e proceseve prodhuese pergjate te gjithë zinxhirit te vleres se shtuar.

**Paga mesatare e sektoreve** e raportuar nga INSTAT eshte 14,056 leke/muaj ne 2001, 5% me e ulet sesa paga mesatare e ekonomise ne pergjithesi (duke perjashtuar nivelet e te ardhurave ne bujqesi). Nderkohe, paga e raportuar nga kontaktet e ACIT me kompanite prodhuese ne sektorin e prodhimit me fason, shenojne vleren 1\$/ore, nder nivelet me te uleta ne rajon dhe ne vendet ne zhvillim. Organizimi dhe manaxhimi ne repartet e punes flasin per rritje te eficences se punes se specializuar.

Paga orare mesatare e punetoreve ne disa vende ne zhvillim eshte: ne Tunizi 1.77\$, Marok 1.89\$, Bullgari 1.01\$, Poloni 2.9\$, Turqi 2.13\$, ndersa ne vendet e Azise jane me te uleta (Indonezi 0.7\$, Kine 0.6\$, Vietnam 0.6\$, Tailande 0.5\$, Indi 0.2\$, Pakistan 0.2\$). Shqiperia qendron ne nivel konkurrues ne raport me vendet e Evropes Lindore, fakt i cili i jep me shume shanse per te care tregjet e BE-se.

**Manaxhimi.** Stafi manaxhues i ndermarrjeve shqiptare perbehet nga inxhinierë, manaxher prodhimi, financier, manaxher shitjesh, te cilet per vete natyren e prodhimit me fason, perqendrojne vemendjen tek prodhimi dhe investimi, dhe jo tek kerkesa dhe analiza e tregut.

Nderkohe industria evropiane karakterizohet nga inovacioni dhe kerkim-zhvillim i bazuar ne ekspertizen dhe kualifikimin e profesioneve te ndryshme ne keto industri.

## **b. Faktoret e prodhimit**

**Mjetet/asetet e industrive.** Mjetet e industrive te konfeksioneve dhe kepuceve jane kryesisht investime ne makineri te reja (teknologji perendimore) te pershtatshme per prodhimet me fason te shitura ne tregun evropian. Keto makineri mbulojne proceset e prerjes, qepjes, hekurosjes. Paketimi kryhet pergjithesisht me dore. Ne industrine e tekstileve, asetet fikse jane pothuajse komplet te amortizuara (te vjetra, nivel i para luftes se dyte boterore; pjeset e kembimit te tyre nuk gjenden me tek shitesit, prandaj prodhohen ne vend, por cilesia eshte e ulet, rrjedhimisht edhe jetegjatesia e shkurter). Gjithashtu, makinerite per kryerjen e proceseve te caktuara teknologjike mungojne. Ne procesin e privatizimit te ndermarrjeve shteterore nuk ishte parashikuar ndonje kusht per investim te detyrueshem ne teknologji, gje qe beri qe ne disa raste ndermarrjet e privatizuara te nderronin destinacion. Nderkohe qe nje pjese e mire u shkaterrua gjate viteve '96, '97. Ne te vertete, mund te thuhet se industria egzistuese nuk karakterizohet nga nje perdorim intensiv i kapitalit, por i punes. Ne industrine e perpunimit te fibres se

leshit, egzistojne vetem makineri per larje dhe presim, si edhe filaturim e tezgjah per numra te larte fijesh, por jo investime serioze per fazat e metejshme te perpunimit. Ne ate te pambukut egziston nje nivel modest i filaturimit dhe endjes per prodhim artikujsh per ushtrine e policine. Makinerite egzistuese gjithashtu i perkasin nje teknologjie te vjeter qe kufizon gamen e produkteve cilesore. Perpunimi i lekures realizohet me teknologji te kushtueshme (perdoruese intensive e kapitalit).

Niveli i investimeve ne vend ne industrine e tekstile/veshjeve dhe lekure/kepuceve paraqiten ne Tabelen 1. Investimet ne asetet industriale per perpunimin e lekures ne fazen e finisazhit te shoqeruar me ekspertizen, kerkimin e tregut dhe bashkepunimin ndermjet aktoreve perkates, do te benin qe kjo industri te ishte me konkurruese dhe te ngrihej ne nje nivel me te larte te vleres se shtuar.

***Lendet e para te industrise se tekstil/veshjeve dhe lekure/kepuceve.*** Shqiperia ka qene nje prodhuese 40-vjecare e fibrave tekstile dhe lekures. Prodhimi aktual i fibrave eshte rreth 3,000 ton lesh (i lidhur ngushte me numrin e krereve ne blegtori) dhe pothuajse fare prodhim pambuku. Ish-kombinati i Tiranes terheq nje pjese shume te vogel te lendes se pare te prodhuar ne vend. Ky burim natyror ka mbetur ende i pashfrytezuar, nderkohe qe nivelet e importit te kesaj fibre perbejne nje sinjal per mundesi te plotesimit te kerkeses se brendshme me prodhime vendase. Ish-kombinati i Beratit punon kryesisht me lende te pare te importuar pambuku. Rrjeti i organizimit ndermjet ofruesve te lendeve te para dhe bleresve te tyre (brenda apo jashte vendit) eshte rastesor dhe i dobet.

Nderkohe per industrine e veshjeve mund te thuhet se lendet e para per prodhimin e veshjeve (te cilat ne realitet jane gjysem-fabrikate) importohen me qellime ri-eksporti pas fazes se permbarimit qe i behet veshjes ne Shqiperi. Rrjeti, cilesia, kostot e tyre jane teresisht te percaktuara nga investitoret e huaj. Perpjekjet per zhvillimin e zinxhirit te vleres se shtuar jane minimale. E njejta situat paraqitet edhe ne zinxhirin e vleres se prodhimit te kepuceve, te cilat pesojne nje transformin minimal (*assembling*) per qellime ri-eksporti.

Perpunimi i lekures paraqet formen e perpunimit me fason (lekura te paperpunuara italiane qe pesojne transformime fiziko-kimike ne Shqiperi me qellim ri-eksporti) dhe formen e perpunimit te lendes se pare vendase (lekura te paperpunuara vendi – kryesisht lekure vici). Kjo e fundit, karakterizohet nga nje organizim i mirefillte i grumbulluesve te vegjel e te medhenj ne te gjitha vendin. Disponueshmeria e lendes se pare (lekures) eshte e lidhur ngushte me konsumin dhe perspektiven e industrise se mishit dhe produkteve te tij. Ne kete kuptim mund te themi se shkalla e aktivitetit te therrtores, percaktohet nga niveli i importeve te mishit qe tejkalon cilesine dhe sigurine e ofruar nga therrtoret vendase. Nga ana tjeter, teknikat e rrjepjes te aplikuara aktualisht ndikojne ndjeshem ne cilesine dhe konkurrueshmerine e lendes se pare. Keshtu, lekura e vicit, per shkak te karakteristikeve specifike te races shqiptare te vicave, paraqet nje produkt me vlere te larte ne tregun nderkombetar. Kjo lekure perpunohet plotesisht ne vend.

Lendet e para ne tregun boteror jane te perqendruara ne vendet ne zhvillim. Prodhimi boteror i fibrave per 2002 ishte 56.1 milion ton, i perbere nga 22.4 milion ton fibra

natyrale dhe 33.6 milion ton fibra artificiale. Fibrat natyrale natyrshem mbizoterohen nga pambuku (21 milion ton) e me pas vjen leshi (1.3 milion ton) dhe mendafshi (90 mije ton). Ndersa prodhimi i fibrave artificiale perbehet nga 2.7 milion ton celuloza dhe 30.9 milion ton fibrat sintetike. Konsumi per fryme i fibrave tekstile ne 2002 ishte 9 kg per fryme, duke shenuar nivelin me te larte te arritur ndonjehere se bashku me nivelin e prodhimit global. Me rritjen e popullsise, edhe konsumi per fryme i fibrave pritjet te rritet. Fibrat artificiale premtojne me shume, sikurse edhe prodhimet tekstile me baze fije te perziera te leshit. Ne BE fibrat artificiale perbejne 72% te konsumit industrial. Ndersa nga fibrat natyrale, pambuku eshte me i perdorshmi (22%). Nderkohe leshi, per vete natyren e produkteve te gatshme qe prodhohen ne BE (pantallona, pulovra, etj me fill leshi te perzier me fije te tjera) ka perdorim me te vogel sesa ne Azi (ku listes se produkteve te leshta i shtohen qilimat, tapetet, sixhadet, etj). Fibra e leshit ze vetem 7% te konsumit industrial ne BE.

Persa i perket lekures, prodhimi boteror i lendeve te para kryesohet nga Amerika Latine me 20.6%. Nderkohe, perpunimi i lekures mbizoterohet nga lekura e gjedheve, e cila perdoret per faqet e sipërme te kepuceve dhe produkte te tjera lekure perfundimtare. Kina eshte prodhuesi kryesor i lekures se rende te perpunuar te gjedhit (36%). Ajo ndiqet nga zona e ish-Bashkimit Sovjetik me 17% te prodhimit boteror te lekures se rende te perpunuar te gjedhit dhe nga Evropa (me 16%), Amerika Latine (14%) dhe Amerika e Veriut me 8%. Edhe persa i perket lekures se lehte te perpunuar te gjedhit, Kina serisht kryeson listen e vendeve perpunuese te saj, e ndjekur nga Evropa dhe Amerika Latine. Mbi 70% e kesaj lende te pare ndodhet ne vendet ne zhvillim, te cilat ne perpjekje per te mbrojtur dhe nxitur industrine vendase te perpunimit te lekureve dhe prodhimit te produkteve te lekures, kane vendosur kufizime ne eksportin e lendes se pare. Per me shume mbi kufizimet ne eksport shih Aneks 9.

### **c. Faktore te tjere mbeshitetes**

**Energjia.** Duke qene se energjitika eshte ende nje sektor i paprivatizuar, cmimi i energjise elektrike (i cili realisht eshte me i ulet sesa cmimi nderkombetar), ka qene nje forme subvencionimi per keto industri. Gjithsesi, rritja e cmimit te energjise elektrike vitin e kaluar, po e ve kete industri perball konkurrences nderkombetare ne pozita me te ashpra. Alternativat e tjera te energjise paraqiten te kushtueshme per aktivitetin e ketij sektori. Konkretisht, kriza energjitike ka perbere nje nga faktoret kyc ne mbylljen e disa ndermarrjeve (shih numrin e ndermarrjeve ne Tabelen 1).

**Klima.** Klima mesdhetare me dimer te ftohte (vecanterisht ne zonat malore) dhe vera e nxehte favorizon egzistencen e nje kerkese vendase te diversifikuar per produkte tekstile e veshjeje te trupit e te kembeve. Aktualisht kjo kerkese plotesohet nga produkte importi.

**Pozita gjeografike.** Pozita gjeografike prane tregjeve te Bashkimit Evropian (vende importuese te medha si Italia, Greqia) favorizon rritjen e transakcioneve tregtare me keto tregje, ndikimin e shpejte te modes dhe plotesimin e nje prej kerkesave themelore te blesesve evropiane: kohe e shkurter ndermjet porosities dhe levrimit. Shume vende ne zhvillim konkurrojne duke gjetur menyra per t'iu pergjigjur ketij kufizimi kohor qe

kerkon tregu i BE-se. Konkurrence e madhe egziston ndermjet vendeve ne Evropën Lindore (Poloni, Rumani, Kroaci, etj) si edhe vendeve te Mesdheut (Tunizi, Marok, Turqi), te cilat operojne shpejt dhe me eficence me rrjetet e shperndarjes.

**Infrastruktura.** Cilesia e ulet e rrugeve rurale e ben te veshtire arrijten e zonave te thella, fakt i cili rrit koston e lendeve te para vendase (fibrave natyrore, lekureve), duke shtuar keshtu nje arsye nje arsye me shume per leverdisshmerine e importit te tyre (shih Aneks 6 dhe 7). Megjithate rrjeti i rrugeve te asfaltuara qe jane ne proces shtrimi do te lehtesojne aksesin ne zonat e thella si edhe me vendet fqinje duke zvogeluar ne kete menyre koston e transaksionit . Kater portet detare te Shqiperise kane ende nevojte per investime per te gene ne nivelin e duhur per rritjen e eficences. Mungesa e impianteve per trajtimin e mbetjeve teknologjike, ndonese sjellin kosto me te uleta per prodhimin, nuk e bejne industrine konkurruese ne afatin e gjate. Linjat e komunikimit jane prezente ne nivel te mire ne zonat urbane (ndonese koston e komunikimit celular mbeten ende serisht te larta), nderkohe qe komunikimi rural eshte ende i dobet. Lidhjet me internet mund te gjenden pothuajse ne te gjitha qytetet kryesore te vendit.

**Tregjet kapitale.** Sistemi bankar ne Shqiperi ka pesuar ndryshime thelbesore gjate 10 viteve te fundit. Ndonese sherbimet bankare jane zhvilluar (megjithese kundrejt tarifave te larta), niveli i kredidhenies mbetet serisht i limituar brenda niveleve te riskut qe bankat mund te marrin persiper. Kolaterali i kredive te dhena kerkohet ne formen e pasurise se paluajtshme ne masen 100-150% te vleres se kredise. Financimi i kompanive aktuale realizohet nepermjet kapitaleve te vete kompanive. Ne shumicen e rasteve, shitjet e ketyre kompanive behen me terma jofavorizues (pagesa te mevonshme deri ne 4 muaj).

**Materiale ndihmese.** Materialet ndihmese, ashtu si edhe lendet e para jane pergjithesisht te importuara.

### 3. KERKESA

Duke u nisur nga perdorimi i produkteve te industrive ne shqyrtim, si edhe nga vendndodhja e blesesve, kerkesa per produktet e ketyre industrive shfaqet ne dy tipe:

**Tabela 4:** Natyra e kerkeses ne industrine e tekstile/veshjeve dhe lekure/kepuceve

Lloji i kerkeses	Kerkesa konsumatore	Kerkesa industriale
Vendase	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Veshje te gatshme (xhaketa, pantallona, funde, fustane, etj) dhe produkte lekure (kepuce, canta, etj)</li> <li>- Tekstile shtepiake (mbulesa, qilima, carcafe, perde, etj)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Produkte gjysem-te gatshme (fill, fiber, lekure, pelhura, etj)</li> <li>- Produkte tekstile e lekure per industrine e mobiljeve dhe ate te ndertimit</li> </ul>
E huaj (kryesisht evropian)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Veshje te gatshme (xhaketa, pantallona, funde, fustane, etj) dhe produkte lekure (kepuce, canta, etj)</li> <li>- Tekstile shtepiake (mbulesa, qilima, carcafe, perde, etj)</li> <li>- Tekstile teknike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fibra tekstile, lekure e paperpunuar dhe e perpunuar</li> <li>- Gjysem-produkte si pelhura, fill, stampime, suprina, etj</li> <li>- Tekstile teknike</li> </ul>

**Burimi:** ACIT



Kerkesa vendase per produktet e industrive ne fjale ka qene e larte dhe gjithnje ne rritje ne vitet e fundit. Kerkesa per veshje trupi dhe kembe eshte plotesuar ne vite kryesisht nga produktet e importit te veshjeve te perdorura te cilat kane qene te afta t'i pergjigjeshin nevojave dhe preferencave me cmime te perballueshme nga portofoli mesatar i konsumatorit vendas (shih Aneks 6 dhe 7). Gjithashtu shume *shuttle trade* zhvillohet per furnizimin e dyqaneve me veshje te modes te blera ne vendet fqinje (Greqi, Itali). Gjithashtu te dhenat statistikore (kapitulli 63 ne Aneksin 6) tregojne per peshe te volumit te importeve te veshjeve te perdorura ne rreth 6% ndaj totalit te tregtise. Ndersa produktet qe prodhohen ne Shqiperi me fason jane veshje te stilit sportiv (xhinse, kemisha, etj) apo per pune apo veshje te brendshme per te cilat kerkesa ne tregun e BE-se eshte vazhdimisht ne rritje, e kunderta vihet re ne preferencat e konsumatoreve vendas te cilet nuk kane tendencen per veshje sportive si konsumatorët evropiane. Preferencat e tyre per veshje te sofistikuara te modes kane filluar te plotesohen ne nje mase modeste edhe nga atelie mode vendase, te cilat kane filluar te dizenojne dhe te shesin produkte me marka te tyre ne vend. Kerkesa industriale per produktet e tekstil/veshjeve (pambuk, lesh, fill, pelhura, etj) ka qene e ulet, perderisa edhe kapacitetet e fabrikave te perpunimit te metejshem te tyre jane shume te uleta.

Integrimi rajonal dhe evropian i ekonomise kane patur efekt te rendesishem mbi industrine dhe mbi kerkesen konsumatore dhe industriale. Keshtu, marreveshja asimetrike e Shqiperise me BE (shih Ankes 8) ka nxitur ne menyre te ndjeshme prodhimin me fason, fenom ky ne te cilin jane perfshire shume vende te Evropes Lindore e Qendrore. Nderkohe mund te thuhet se kerkesa vendase nuk ka qene dhe nuk eshte aspak nje faktor zhvillimi per kete industri. Prodhuesit aktuale nuk duken te jene shume te interesuar per kerkesen vendase per veshje dhe tekstile. Gjithashtu, nuk egzistojne struktura te shperndarjes se produkteve (prodhuesa, shitesa me shumice, shitesa me pakice, agjente, etj) te cilet te mund te shfrytezojne avantazhet e egzistences se kerkeses vendase.

### ***Por si paraqitet kerkesa e huaj ne industrite ne fjale?***

- **Kerkesa ne industrine e tekstile/veshjeve:**

**Konsumi** total i BE per veshje ne vitin 2000 arriti vleren 196 miliard USD, nga te cilat 163 miliard ishin per veshje te jashtme te trupit. Veshjet e jashtme per gra jane sektori me i sukseshem duke perfaqesuar 48% te tregut te veshjeve te jashtme te trupit. Gjermania eshte vendi me konsumator i veshjeve te jashtme te trupit e ndjekur, me nje diference qe po zvogelohet gjithnje e me shume, nga Britania e Madhe dhe Italia. Keto tre vende se bashku me Francen dhe Spanjen perbejne 80% te konsumit per veshje ne BE.

Gjermania perben konsumatorin me te madh per shkak te popullsise se saj te madhe dhe fuqise blerese. Konsumatori gjerman i dedikon veshjeve nje perqindje te mire te portofolit te tij. Tregu gjerman eshte dominuar nga veshjet e importit si pasoje e renies se prodhimit vendas per shkak te cmimeve te uleta qe ofrojne prodhuesit jashte BE-se. Mbi 20% e veshjeve te jashtme per gra te shitura ne Gjermani ne 2000 jane pantallona dhe

xhinse, 13.3% bluza dhe kemisha, 7.3% fustane dhe 6.1% funde. Nderkohe veshjet e jashtme per burra perbehen nga 31% pantallona dhe xhinse dhe 20% kemisha.

Britania e Madhe eshte konsumatori i dyte me i madh ne BE. Veshjet e jashtme per gra jane gjithshu me te shiturat dhe mbulojne mbi gjysmen e tregut te veshjeve te jashtme te trupit. Shitjet e bluzave, kemishave, fustaneve, fundeve, kostumeve dhe xhaketave rane, por shitjet e pantallonave kazuale dhe t-shirts u rriten dhe arriten perkatesisht 45 milione dhe 49 milion cope te shitura ne 2000. Edhe shitjet e veshjeve te jashtme te thurrura si triko, kardigan, pulovra u rriten gjithashtu. Cmimet mesatare per veshjet e jashtme per gra rane me 2% si rezultat i konkurrences intensive ne shitjen me pakice. Volumi i shitjeve per veshjet sportive per gra u rrit gjithashtu. Parashikimet per tregun e veshjeve te jashtme sportive per gra ne Britanine e Madhe jane shume optimiste dhe ne rritje me shume per sasine, sesa per vleren.

**Tabela 5:** Vlera e shitjeve te veshjeve te jashtme ne %, 2000

Lloji i veshjes jashtme	BE(15 vende)	Gjermania	Hollanda	Franca	Italia	Britania e Madhe
Per gra	48.1	53.6	47.2	40.8	45.6	51.8
Per burra	30.4	31.2	32.4	28.7	33.4	27.2
Per femije	11.4	8.9	9.3	15.8	11.8	10.6
Aksesore veshjesh	3.7	2.1	4.2	6.3	2.4	3.7
Sportive	6.4	4.2	6.9	8.4	6.8	6.7
TOTAL	100	100	100	100	100	100

**Burimi:** Qendra per promovimin e importeve evropiane nga vendet ne zhvillim

Ne shume vende te BE kerkesa per veshje formale (tradicionalisht zyrtare) po bie, nderkohe qe po rritet kerkesa per veshje kazuale dhe veshje baze aktive. Po ashtu, veshjet sportive po shtrijne ndikimin e tyre mbi segmentet e veshjeve kazuale dhe atyre baze aktive. Veshja formale ne ambientet e zyrave parashikohet te humbe terren dhe vendin po e ze gradualisht veshja “kazuale e zgjuar”. Kerkesa per t-shirts, polo shirts, kanatiere sportive, bluza e pulovra eshte rritur ne te gjitha vendet e BE-se. Veshjet e jashtme per grate jane me te shiturat nga veshjet e jashtme, sepse grate reagojne me ndjeshem ndaj modes dhe blejne ne menyre me impulsive.

**Importet** boterore te sektorit te tekstile/veshjeve kryesohen nga Evropa (me 40% te totalit te importeve tekstile boterore dhe 45% te totalit boteror te veshjeve ne 1998). Kerkesa per importin e tekstileve dhe veshjeve ne BE ka qene ne rritje ne vite. Importet evropiane te veshjeve te jashtme te trupit rane me 6.4% gjate periudhes 1998-2000 (duke arritur vleren 58.3 miliard USD), nderkohe qe shprehur ne Euro importet u rriten me 14% (duke arritur vleren 63.3 miliard USD). Importet qe vinin nga jashte BE-se u rriten me 10%, ndersa tregtia ndermjet anetareve te BE-se ra me rreth 30%. Gjermania mbetet serisht importuesi kryesor (27% te vleres totale) e ndjekur nga Britania e Madhe (17%), Franca (15%), Italia (8%), Hollanda (7%), Belgjika (6.5%), Spanja (5%) dhe Austria (4%).

**Tabela 6:** Importet evropiane per veshjet e jashtme te trupit, 2000, ne mije USD

Pershkrimi	Njesia masese	Importet totale te BE		Eksportet e Shqiperise ne BE		Pesha e Shqiperise ne importet e BE (ne %)
		sasia	vlera	Sasia	Vlera	
<b>TE THURRURA</b>						
Pallto te medha, xhupa, pelerinat, mantelet, xhaketa kundra eres	Nr	39.1	456,000	74,870	354	0.078
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			16,107	172	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			58,763	182	
Kostume, ensemble (komplete)		156.3	404,000	31,451	104	0.026
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			6,040	50	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			25,411	54	
Xhaketa te lehta (per ambiente brenda)	Nr	22.5	279,000	4,055	38	0.014
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			1,508	20	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			2,547	19	
Pantallona e kominoshe te gjata/shkurt	Nr	398.5	1,720,000	369,030	1,235	0.072
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			91,656	387	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			277,374	848	
Fustane dhe funde	Nr	117.4	744,000	9,268	42	0.006
Bluza dhe kemisha	Nr	483	2,091,000	1,386,350	2,848	0.136
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			55,653	178	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			1,330,697	2,670	
Pulovra, triko, fanella te thurrura	Nr	1,293.5	9,766,000	450,935	887	0.009
t-shirts	Nr	1,979.1	6,175,000	2,753,866	4,005	0.065
Veshje sportive	Nr	47.3	934,000	1,439,136	3,531	0.378
Aksesore veshjesh (doreza)	Nr	390.6	454,000			0.000
Te tjera	Kg	-	1,392,000	315,849	5,567	0.400
<b>Totali i veshjeve te thurrura</b>		<b>4,927.3</b>	<b>24,415,000</b>	<b>8,700,566</b>	<b>23,194</b>	<b>1.18</b>
<b>TE ENDURA</b>						
Pallto te medha, xhupa, pelerinat, mantelet, xhaketa kundra eres	Nr	246.1	4,844,000	13,069,738	1,190	0.025
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			6,462,776	308	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			6,606,962	881	
Kostume, ensemble (komplete)	Nr	98.6	1,942,000	180,441	850	0.044
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			73,736	412	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			106,705	439	
Xhaketa te lehta (per ambiente brenda)	Nr	132.1	2,697,000	104,668	622	0.023
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			80,948	433	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			23,720	189	
Pantallona e kominoshe te gjata/ shkur	Nr	1,302.7	11,628,000	6,889,166	23,112	0.199
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			6,590,616	21,795	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			298,550	1,318	
Fustane dhe funde	Nr	339.1	2,919,000	9,268	42	0.001
Bluza dhe kemisha	Nr	898	5,526,000	29,860,073	30,340	0.549
<i>per meshkuj</i>	<i>Nr</i>			14,024,796	21,627	
<i>per femra</i>	<i>Nr</i>			15,835,277	8,712	
Veshje sportive	Kg	40.1	1,289,000	16,967,434	1,484	0.115
Aksesore veshjesh (doreza)		294.3	1,193,000	0	0	0.000
Te tjera	Kg	7.5	1,865,000	50,465,277	2,208	0.118
<b>Totali i veshjeve te endura</b>		<b>3,358.5</b>	<b>33,903,000</b>	<b>16,765,0151</b>	<b>115,962</b>	<b>1.07</b>

Burimi: ACIT, Qendra Evropiane per Promovimin e Importeve

Importet e veshjeve te jashtme te thurrura u rriten ne sasi (me 18%) gjate periudhes 1998-2000, por rane ne vlere (-3.8%) duke deshmuar per nje renie te cmimit mesatar te importit. 65% e importeve evropiane per veshje te jashtme te thurrura perfaqesohen nga dy nengrupe: pulova e triko leshi dhe T-shirts. 47% e importeve per veshjet e jashtme te thurrura erdhen nga vendet ne zhvillim.

Importet e veshjeve te endura u rriten gjithashtu ne sasi (14.4%) dhe rane ne vlere (8.2%) gjate periudhes 1998-2000. Roli i vendeve ne zhvillim ne kete sektor ka qene me i madh, sepse vetem 38% e veshjeve te jashtme te endura kane patur si furnizues vete vendet anetare te BE-se. Per veshjet e jashtme te thurrura, Turqia, Kina, Bangladeshi, India, Indonezia Maroku kryesojne listen, ndersa per veshjet e jashtme te endura eksportuesit me te medhenj jane Kina, Turqia, Maroku, Tunizia, etj.

65% e importeve evropiane ne vitin 2000 per veshjet e thurrura perfaqesohen nga trikot, pulovrat, polo shirts dhe t-shirts (shih Tabelen 6). Nderkohe qe Shqiperia ka alokuar me teper burimet e saj prodhuese ne eksportin e t-shirts, veshjeve sportive dhe bluza/kemishave. Meqe t-shirts dhe triko/pulovrat shfain norma rritese konsumi dhe importi, egziston nje oportunitet per Shqiperine per te rritur eksportet e t-shirts dhe per te zgjeruar eksportin ne segmentin e triko/pulovrave, produkte te cilat aktualisht nuk perbejne prioritetin e eksporteve shqiptare te veshjeve te thurrura. Pesha aktuale per to eshte teper e vogel (0.009% per pulovrat e thurrura, 0.065% per t-shirts). Tabela 7 ilustron mundesine per te hyre ne tregun gjerman, francez e anglez te triko/pulovrave.

**Tabela 7: Tregu aktual dhe potencial i triko/pulovrave**

<b>Importet ne BE (viti 2000)</b>	Hollanda	Gjermania	Franca	Anglia	Italia
Per meshkuj	236.2	451.4	317.3	413.1	348.7
Per femra	429.9	2224.8	1116.9	1025	398.9
Uniseks + femijet	36.8	124.2	100.7	93	52.6
TOTAL mil.\$	702.9	2800.4	1534.9	1531.1	800.2

<b>Eksportet shqiptare mije \$</b>	Gjermani	Greqi	Itali	Maqedoni	Total
1999	905.9	939.49	399.6	-	2245
2000	-	494.33	392.6	-	886.9
2001	-	323.9	839.9	3	1167
2002	-	152.3	2177.4	-	2329.7

**Burimi:** ACIT, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave

Ndersa shumica e eksporteve shqiptare te ketij produkti shkojne drejt Italise, Italia perben vendin e katert ne BE per importin e ketij produkti. Tregu gjerman i cili kryeson listen e vendeve te BE per importin e ketij produkti, perben nje potencial per shitjen e produkteve shqiptare.

Ne importet e produkteve te endura te BE kane kryesuar pantallonat e gjata dhe te shkurtra si edhe kemishat dhe bluzat. Pikerisht keto dy produkte perbejne edhe produktet primare ne eksportet shqiptare te veshjeve te jashtme ne BE (shih Tabelen 6).

Gjermania eshte importuesi me i madh i veshjeve te jashtme te trupit ne BE me rreth 17 miliard Euro nga te cilat 48% blihen nga vendet ne zhvillim nepermjet operacioneve te ri-importit ose importit direkt (shih Aneks 10). Nje rritje te konsiderueshme kane patur importet e trikove, pulovrave, etj per femra si edhe pantallonat e endura per meshkuj e femra. Nderkohe importet e pulovrave dhe bluzave per meshkuj, kemishave te endura dhe bluzave per meshkuj e femra si edhe shallat e endura kane pesuar renie ne vitin 2000. Furnizuesi kryesor i Gjermanise per veshjet e jashtme te trupit eshte Turqia me 14% te importeve totale te Gjermanise. Ajo ndiqet nga Italia, Kina, Polonia (kryesisht riimport), Rumania (kryesisht ri-import), Hollanda, Greqia, Bangladeshi, etj.

Britania e Madhe eshte importuesja e dyte me e madhe evropiane. Prodhuesit britanike punojne me OPT 78% te veshjeve te thurrura te importuara dhe 73% te veshjeve te endura te importuara. Rritje pozitive kane patur importet e Britanise se Madhe per disa produkte: triko, pulovra per meshkuj dhe femra, T-shirts, veshjet e endura si pantallonat, fundet, kostumet sportive, shallat. Nderkohe qe importet e kostumeve dhe dorezave te thurrura kane pesuar renie. Eksportuesit kryesore te veshjeve per tregun angelez jane Kina, Turqia dhe Hong Kongu. Franca eshte gjithashtu nje importuese e fuqishme ne BE. 46% e importeve te saj vjen nga vendet ne zhvillim. Vendet kryesore eksportuese ne tregun francez jane Italia, Maroku, Tunizia, etj.

Italia gjithashtu ne vitin 2000 ka kryer importe te medha te veshjeve te jashtme te trupit. Ato arriten vleren 5.2 miliard Euro nga te cilat 74% ishin ri-importe nga vende jashte BE-se. 48% e importeve italiane erdhen nga vendet ne zhvillim. Norma e rritjes se importeve ne Itali ka qene positive ne vitet e fundit. Mbi normen mesatare jane shfaqur importet e t-shirts, trikove, pulovrave, fundeve dhe bluzave te thurrura per gra, nderkohe qe per veshjet e endura tipike kane qene pantallonat per grate dhe fundet. Kemishat per burra kane pesuar renie. Kina eshte kryesuesja e eksportuesve per tregun Italian, e ndjekur nga Tunizia, Rumania, Franca, Belgjika, Bangladeshi, Kroacia dhe Turqia.

- **Kerkesa ne industrine e lekure/kepuceve:**

**Konsumi** boteror i kepuceve kryesohet 42% nga Azia (ku 21% i takon Kines), e ndjekur nga Amerika dhe Evropa. Ne termat e konsumit per fryme, SHBA kryeson listen (me 6.2 pale/fryme/vit) e ndjekur nga 6 vende evropiane (Danimarka me 5.8 pale/vit, Franca me 5.6, Anglia 5.1, Zvicra 5.1, etj). Volumi i tregtise globale formale ne kete sektor (43 miliard dollare) se bashku me volumin e asaj informale (qe besohet te kete te njejten vlere me tregtine formale), eshte rreth 3 here me e larte se vlere e tregtise boterore te mishit dhe me shume se 3 here me e larte se ajo e sheqerit. Bleresit me te medhenj jane SHBA me 1,462 milion pale ne vitin 1997, Hong-Kong me 1,298 milion pale, Japonia me 384 milion pale, Gjermania me 345 milion pale, Anglia me 247 milion, Franca me 245 milion, Italia me 158 milion, etj.

Konsumi i veshjeve te kembeve ne Evrope, sipas sondazheve te kryera nga Qendra Evropiane per Promovimin e Importeve, ka patur nje rritje te vazhdueshme ne vitet e fundit. Ky treg pergjithesisht eshte karakterizuar nga artikuj te lire, me natyre konsumi masiv, nderkohe qe ne vitet e fundit ai ka tentuar me teper drejt produkteve me cilesi me te larte dhe natyre individuale. Gjermania eshte konsumatori me i madh ne Evrope per veshjet e kembeve (379 milion pale), e ndjekur nga Italia (329 milion pale), Anglia, Franca, Spanja dhe Hollanda. Keto vende perfaqesojne 81% te konsumit evropian te veshjeve te kembeve. Nderkohe qe vete konsumi evropian i veshjeve te kembeve perfaqeson 1.1% te shpenzimeve totale konsumatore ne BE. Gjithsesi modeli i konsumit varion sipas kultures, traditave dhe shijeve ne vende te ndryshme anetare te BE-se. Keshtu ne Gjermani, zhvillimet ne tregun e veshjeve te kembeve jane rezultat i disa faktoreve si: kufizimet ekonomike per konsum, konkurrenca e madhe per cmimet, importet ne rritje nga vendet me kosto te uleta prodhimi (importe direkte ose ri-importe te prodhuesve gjermane), etj. Veshjet e kembeve per gra zene 54% te sektorit ne Gjermani. Veshjet e kembeve te cilesise se larte zene nje peshe te mire ne sektor, nderkohe qe ato me cmime te uleta jane kryesisht kepuce me faqe material tekstil nga Kina dhe vende te tjera aziatike. Ne Itali paraqitet nje tendence per kepuce te shtrenjta. Presioni mbi cmimin e kepuceve vitet e fundit ka qene i larte si rezultat i renies se prodhimit dhe eksporteve vendase (kryesisht ne kepuce te modes dhe ato sportive) si edhe per shkak te importeve ne rritje nga Azia apo vende te tjera te BE-se. Sipas Eurostat, konsumi i veshjeve te kembeve ne Itali ne vitin 2000 eshte shperndare ne konsum per veshje te kembeve me faqe lekure 157 milion pale, me faqe sintetike 58 milion pale, me faqe material tekstili 47.6 milion, me faqe gome 8.5 milion pale, shapka 54.6 milion pale. Pesha e konsumit te veshjeve te kembeve per femra ne tregun italian eshte 54%, per meshkuj 25% dhe femije 21%. Konsumi ne kete sektor ne France arrin 320 milion pale kepuce dhe Angli 220 milion pale.

Tregjet e konsumit te veshjeve te kembeve ne BE perbehen nga segmente te kategorizuara sipas:

- raportit cmim/cilesi
  1. raport cmim/cilesi i ulet dhe shume i ulet; niveli i modes: per imitues te modes; ndodhet ne te gjitha vendet e BE-se;
  2. raport cmim/cilesi i ulet dhe i mesem; niveli i modes: pranues te modes; kryesisht ne Gjermani, Angli dhe Hollande sepse keta konsumatore jane me pak te ndjeshem ndaj modes;
  3. cmim i mesem dhe i larte, mode e kepuceve me marka e klasike; niveli i modes: komfort, i pershtatshem; kryesisht ne Gjermani, Angli dhe Hollande sepse keta konsumatore jane me pak te ndjeshem ndaj modes;
  4. mode e larte jo domosdoshmerisht me raport te larte cmim/cilesi; niveli i modes: krijuesit e tendences; kryesisht gjendet ne Itali e France;
  5. raport i larte cmim/cilesi; niveli i modes: pranues te modes; kryesisht gjendet ne Itali e France;

- perdoruesve
  1. bazuar ne demografine; madhesia dhe struktura moshore percakton konsumin e veshjeve te kembeve. Tabela 3.6 tregon per perberjen e grupmoshave ne BE;
  2. bazuar ne faktoret socio-ekonomike; pesha e shpenzimeve ne portofolin e shpenzimeve te konsumatoreve ka qene ne renie. Keshtu 1.36% e shpenzimeve totale te italianeve shkojne per kepuce, 1.96% per spanjolllet, 1.15% per francezet, dhe me pak per vendet e tjera te BE-se;
  3. bazuar ne aspektet sezonale; moti kushtezon kohen e konsumit; ndryshimet e papritura te motit percaktojne edhe vendimet e blerjes.

**Importet** e veshjeve te kembeve te raportuara nga Eurostat nuk perfshijne vleren e importeve kineze te hyra kontrabande ne BE nepermjet vendeve te tjera. Gjithsesi, shifra e raportuar per vitin 2000 eshte 19.4 miliard Euro (shih Aneks 12), nga te cilat 22% importohen nga Gjermania, 17% nga Anglia, 15% nga Franca, 13% nga Italia, etj. Ne vitet e fundit, vende te ndryshme te BE-se kane paraqitur tendenca te ndryshme ne nivelin e importeve:

- ulje teper e madhe e importeve (mbi 10%) ne Portugali, Finlande, Gjermani dhe Belgjike;
- ulje e madhe e importeve (5-10%) ne Angli dhe Austri;
- ulje e vogel e importeve (me pak se 5%) ne Suedi dhe Greqi;
- rritje e vogel e importeve (me pak se 5%) ne Itali, France, Hollande, Danimarkë dhe Irlandë
- rritje e madhe e importeve (mbi 10%) ne Spanje.

Niveli i importeve varion sipas peshes se faktoreve te tjere si: prodhimi i brendshem, mundesite e ri-eksportit dhe zhvillimet ne kerkesen e brendshme. Keshtu ne Spanje importet i referohen kryesisht markave te medha belge, italiane e hollandeze te kepuceve te lekures dhe sportivet, ndersa produktet me cmime te uleta e kane origjinen e tyre nga vendet ne zhvillim (kryesisht Vietnam, Kine dhe Marok). Tregu spanjoll permbush kerkesat per artikuj te cilesise se mesme dhe te larte te kepuceve. Tabela 8 na jep te dhenat mbi importet e vendeve evropiane:

Rreth 52% e importeve totale te BE-se jane me origjine intra-BE (nga vende anetare te BE-se), ku rreth 17% vijne nga Italia (furnitori kryesor i BE-se me 240 milion pale). Por pesha e importeve intra-BE ka qene ne renie vitet e fundit. Nga kjo kane perfituar vendet ne zhvillim si psh vendet e Evropes Lindore (kryesisht Rumania) dhe vendet aziatike (kryesisht Taivani). Per me shume ne lidhje me importet sipas furnitoreve dhe sipas llojeve te veshjeve te kembeve, shih perkatesisht Aneks 11 dhe Aneks 12. Importet me te larta shenohen nga veshjet e kembeve me material lekure dhe ato me material tekstili.

**Tabela 8:** Zhvillimet ne importet evropiane te veshjeve te kembeve, ne milion USD

Vendet	1997	1998	1999	2000	Perqindja e ndryshimit 1997-2000
Gjermania	4,776	4,580	4,503	4,002	-16.2
Anglia	3,141	3,143	3,326	3,005	-4.3
Franca	2,778	2,802	2,711	2,763	-0.5
Italia	2,174	2,177	2,298	2,395	+10.2
Hollanda	1,150	1,201	1,337	1,360	+18.3
Belgjike/Luks	1,296	1,117	1,266	1,139	-12.1
Austria	824	808	824	761	-7.6
Spanje	441	615	556	638	+44.7
Danimarka	466	477	431	437	-6.2
Suedia	415	416	393	385	-7.2
Portugalia	317	341	353	300	-5.4
Greqia	291	280	257	253	-13.1
Irlanda	254	259	252	260	+2.4
Finlanda	196	188	179	157	-19.9

**Burimi:** Eurostat, Qendra Evropiane per Promovimin e Importeve

#### 4. STRATEGJIA, STRUKTURA DHE RIVALITETI

Numri i firmave ne industrine e tekstile/veshjeve ka pesuar nje renie ne dy vitet e fundit per shkak te krizes energjitike. Serisht, struktura e industrise se veshjeve te trupit dhe te kembeve paraqitet si nje dege me konkurrence ku shume firma u shesin shume bleresve perendimore evropiane. Fuqia negociuese eshte minimale duke qene se cmimet, termat, cilesia, asortimentet e produkteve, dizenjot, etj percaktohen nga bleresit evropiane te cilet njohin dhe vendosin kontaktet me rrjetet evropiane te shitjes se veshjeve. Produktet qe aktualisht prodhohen jane ato te kerkuara nga tregu, ndonese kerkesa ne rritje ne BE per shume produkte te tjera jep sinjale pozitive per mundesi te reja ne Shqiperi per prodhimin e veshjeve. Ne industrine e perpunimit te lekures, numri i firmave eshte me i vogel. Ato kane ndare tregjet lokale brenda vendit per furnizimin me lende te para dhe kane partnere te huaj te ndryshem.

Firmat ndjekin strategji afat-mesme ne tendence me zhvillimet ne tregun evropian. Ato jane te orientuara nga cilesia e arritur me kosto te ulet prodhimi (per shkak te koston se punes), e cila perben edhe avantazhin e tyre ne konkurrencen ne tregun evropian. Produktet e prodhuara jane te cilesise se larte per konsum perfundimtar nga masa te gjera konsumatoresh te veshjeve sportive, te punes, etj. Manaxheret jane te perqendruar me shume ne proceset prodhuese sesa ato te marketingut, duke mos ndjekur shume nga afer tendencat dhe te rejat e tregut nderkombetar (persa i perket modes, cmimeve, dizenjove, etj). Kerkimi i tregut eshte nje funksion qe nuk kryhet per vete faktin se kompanite meme ne vendet evropiane te cilat i kane krijuar ne shumicen e rasteve keto ndermarrje te perbashketa zhvillojne ne Shqiperi vetem nje-dy operacione brenda kuadrit te aktivitetit te tyre kryesor i cili zhvillohet jashte Shqiperise. Kjo ka cuar edhe ne mungesen e njohurive mbi segmente te vogla te tregut qe mund te kapen. Kontaktet direkte me bleresat evropiane, pjesemarrjet ne panair, dergimi i mostrave, pra nje strategji



marketingu eshte e limituar ne ndermarrjet egzistuese ne vend. Ndjenja e kerkimit te klienteve vete ne menyre aktive nuk eshte ne nivelin e deshirueshem.

Konkurrentet direkt te eskporteve shqiptare ne dy industrite ne fjale jane vendet ne zhvillim. Duke iu referuar Aneksit 11 per veshjet e kembeve, vihet re se pjesa e tregut qe kane keto vende ne BE eshte rreth 35%.. Keshtu, per veshjet e kembeve konkurrentet direkte jane Kina, Belgjika, Spanja, Vietnami, Rumania, Polonia, Bullgaria, Tunizia, etj. Nderkohe per veshjet e jashtme te trupit Shqiperia konkurrohet nga vendet e paraqitura ne Tabelen 9, te cilat prodhojne me sistemin me porosi (OPT).

**Tabela 9:** Prodhimi OPT sipas partnereve tregtare, 2000

Vendet	Vlera OPT ne 2000 (ne milion USD)	Partneret kryesore tregtare
BE (15 vende)	3,367	Rumani (18%), Polonia (13%), Bullgaria (8%), Maroku (7%)
Gjermania	1,548	Rumania (21%), Polonia (14%), Ukraina (7%), Kroacia (6%)
Britania e Madhe	504	Rumania (19%), Maroku (17%), Sri Lanka (16%), Indonesia (6%)
Italia	306	Rumania (44%), Hungaria (12%), Bullgaria (7%), Kina (7%)
Franca	226	Maroku (31%), Tunizia (19%), Rumania (12%), Polonia (12%)
Hollanda	169	Polonia (17%), Bjellorusia (11%), Kroacia (8%), Maroku (8%)

**Burimi:** Qendra Evropiane e Promovimit te Importeve, Eurostat

Prodhimi me porosi eshte shnderruar ne nje metode efikase per shume kompani ne vendet e zhvilluara ne sektorin e veshjeve dhe kepuceve, te cilat e gjejne me interes prodhimin ne kete menyre ne vendet ne zhvillim per disa arsye:

- rritje te kapaciteteve dhe fleksibilitetit te tyre pa investuar
- specializim
- kosto prodhimi me te uleta
- kohe levrimi me te vogla
